



RREGULLORE

TIRANA THROWDOWN 2024

1. EVENTI:

Tirana Throwdown 2024 është event i parë dhe më i madh i këtij lloji që zhvillohet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në edicionin e tij të dytë, Tirana Throwdown do të mbahet në datat 26-27-28 Prill, ku përkatësisht në datën 26 Prill do bëhet hapja e eventit dhe briefing i workoutetve, ndërsa në datat 27 dhe 28 Prill, do të zhvillohen garat të ndara në 5 workoute gjithsej, përfshirë dhe garën finale.

2. REGJISTRIMET:

Regjistrimet për të gjithë atletët pjesmarrës do të hapen në datën 01 Shkurt 2024 dhe do të kryhen nëpërmjet platformës Reventy (reventy.com). Regjistrimet do zgjasin deri në datën 1 Prill 2023, ora 23:59, me orën lokale të Tiranës. Gjithashtu organizatorët e Tirana Throwdown rezervojnë të drejtën për të mbyllur edhe përpara këtij afati regjistrimet, nëse plotësohet numri maksimal i atletëve pjesmarrës.

Për t'u bërë pjesë e TIRANA THROWDOWN, çdo atlet duhet:

- Të ketë mbushur moshën madhore 18 vjeç në datën e fillimit të eventit (***Atletët e moshës 16-18 vjeç, mund të bëhen pjesë e kategorisë së veçantë të garës, vetëm me aprovimin e shprehur të njërit prej prindërve***)
- Të ketë paguar tarifën prej 50 eurosh për pjesmarrje në event brenda datës 1 Prill 2024.
- Të arrijë të përmbushë standartet e pjesmarrjes për secilën kategori
- Të ketë nënshkruar Deklaratën e Lirimit nga Përgjegjësia së bashku me rregullat e Privacy.

Tarifat e regjistrimit nuk janë të kthyeshme për asnjë arsye si dhe regjistrimet nuk janë të transferueshme tek asnjë person tjetër për asnjë arsye.

3. KATEGORITË:

Në Tirana Throwdown, atletët do të garojnë në 10 kategori, konkretisht:

- | | |
|----------------------------------|-----------|
| • Kategoria ELITE FEMRA | 20 atletë |
| • Kategoria ELITE MESHKUJ | 40 atletë |
| • Kategoria SCALED FEMRA | 60 atletë |
| • Kategoria SCALED MESHKUJ | 80 atletë |
| • *Kategoria MASTER FEMRA 35-39 | 10 atletë |
| • *Kategoria MASTER FEMRA 39+ | 10 atletë |
| • Kategoria MASTER MESHKUJ 35-39 | 20 atletë |
| • Kategoria MASTER MESHKUJ 39-44 | 20 atletë |
| • *Kategoria MASTER MESHKUJ 45+ | 10 atletë |
| • *Kategoria SCALED ADOLESHENTË | 10 atletë |



*- Regjistrimi për këto kategori do hapen, por nëse nuk mbushet numri minimal prej 10 atletësh, atletët që janë regjistruar do zhvendosen në kategoritë e tjera.

4. KLAUZOLA MOS PRANIMI:

Organizatorët e eventit rezervojnë të drejtën e padiskutueshme dhe të paapelueshme për të pranuar ose refuzuar regjistrimin e një atleti nëse shkelen rregullat e vendosura nga ata.

5. STANDARDET E KATEGORIVE:

Për të garuar në secilën prej 5 kategorive, atletët duhet të përmbushin standartet kryesore që ka secila prej këtyre kategorive, e konkretisht:

ELITE:

FEMRA

Snatch 55 kg
Clean & Jerk 65 kg
Double Dumbell 15 kg
Double Unders
Chest to Bar Pull Ups
HSPU
Toes to Bar
Rope Climbs

MESHKUJ

Snatch 80 kg
Clean & Jerk 100 kg
Double Dumbell 22.5 kg
Double Unders
Muscle Ups/Ring Muscle Ups
HS walk
Toes to Bar
Rope Climbs

SCALED:

FEMRA

Snatch 30 kg
Clean & Jerk 45 kg
Deadlift 60 kg
Double Dumbell 10 kg
Pull Ups
Wall Walks
Toes to Ring

MESHKUJ

Snatch 50 kg
Clean & Jerk 65 kg
Deadlift 100 kg
Double Dumbell 15 kg
Pull Ups
Wall Walks
Toes to Bar/Toes to Ring



MASTER:

FEMRA 35-39/ FEMRA 40+

Snatch 30 kg
Clean & Jerk 45 kg
Deadlift 60 kg
Double Dumbell 10 kg
Pull Ups
Wall WalkS
Toes to Ring

MESHKUJ 35-39/ MESHKUJ 40-44/ MESHKUJ 45+

Snatch 50 kg
Clean & Jerk 65 kg
Deadlift 100 kg
Double Dumbell 15 kg
Pull Ups
Wall WalkS
Toes to Bar/Toes to Ring

ADOLESHENTË

FEMRA

Snatch 25 kg
Clean & Jerk 35 kg
Deadlift 50 kg
Double Dumbell 10 kg
Pull Ups
Wall WalkS
Toes to Ring

MESHKUJ

Snatch 40 kg
Clean & Jerk 55 kg
Deadlift 80 kg
Double Dumbell 15 kg
Pull Ups
Wall WalkS
Toes to Bar/Toes to Ring

6. CHECK-IN:

Të gjithë atletët duhet të bëjnë check-in në vendin ku do zhvillohet eventi, të premten në datën 26.04.2024, prej orës 18:30-19:30 sipas kohës lokale të Shqipërisë. Briefing do të zhvillohet nga ora 19:30-21:30.

Në momentin e check-in, atleti duhet të ketë me vete të printuar Deklaratën e Lirimit nga Përgjegjësia së bashku me rregullat e Privacy. Nëse nuk e ka me vete, është i detyruar që të nënshkruajë kopjen e saj pranë Check In-it.

Nëse një atlet humbet check-in, atëherë ai do të ketë mundësinë e fundit për check-in të shtunën, datë 27.04.2024, midis orës 07:30-08:30 ndërsa nuk do ketë një mundësi të dytë për briefing.

Gjithsesi, një material me standartet e gjithë workouteve do publikohet dhe do jetë i aksesueshëm për atletët disa ditë para filimit të eventit.

7. GARA

Gara do të ndahet në 2 ditë, përkatësisht dita e parë do ketë 2 workoute dhe dita e dytë do ketë 3 workoute, ku workouti i fundit do jetë edhe finalja.

Ora e fillimit të secilës bateri dhe pjesamrrësit në secilën prej tyre, do u bëhen me dije atletëve disa ditë përpara garës. Është përgjegjësi personale e atletëve që të jenë në vendin e organizimit të eventit në



kohën e përcaktuar për të filluar garën bateria e tij. Nëse nuk janë aty në kohë për çfarëdo arsye, atëherë ata **nuk mund** të konkurrojnë në një bateri tjetër në një kohë tjetër.

Në fund të ditës së parë të garës, bateritë për ditën e dytë do të ndryshojnë në bazë të performancës së atletëve dhe atletëve do të njoftohet paraprakisht për orën në të cilën do zhvillojë garën bateria e tij, duke u postuar në website si dhe në kanalin e instagrame të TIRANA THROWDOWN.

Në fund të secilës garë, do bëhet edhe pikëzimi i atletëve pjesmarrës, ku atleti që ka dalë i pari në një workout, do marrë 1 pikë penalizim, atleti që ka dalë i dyti do marrë 2 pikë penalizim dhe kështu me rradhë.

Në fund të 4 workouteve, do bëhet edhe mbledhja e pikëve përfundimtare, ku atletët që kanë marrë më pak pikë penalizim dhe që janë renditur në vendet e para për çdo kategori, do bëhen pjesë e garës finale.

Numri i atletëve që do marrin pjesë në garën finale për çdo kategori do jete nga 5 deri në 10 atletë, bazuar në numrin përfundimtar të pjesmarrësve për secilën kategori. Numri ekzakt do behet me dije në momentin që regjistrimet do të mbyllën.

Pikët e marra gjatë finales, do i bashkohen pikëve të marra në 4 fazat e mëparshme, ku në përfundim, do shpallet dhe fituesi.

Në rast të një barazimi midis dy ose më shumë atletëve gjatë eventit, zbatohet politika e mëposhtme e barazimit:

Fillimisht do merret në konsideratë se cili atlet është renditur në vendin e parë më shpesh. Ai me më shumë renditje në vendin e parë do shpallet fitues. Nëse ka ende një barazim, do shqyrtohet se sa herë është renditur secili atlet i dyti, e nëse përsëri janë barazim, kalojmë tek renditja në vend të tretë, të katërt e kështu me rradhë.

Nëse pas të gjithë këtyre hapave, përsëri atletët janë barazim, do merret në konsideratë renditja në garën finale.

8. RREGULLAT E SJELJES DHE VENDIMET E GJYQTARËVE:

Ekipi i Gjyqtarëve të Tirana Throwdown ka autoritetin përfundimtar për të gjitha kërkesat dhe ankesat që mund të kenë atletët.

HEAD JUDGE është figura që i është besuar menaxhimi i EVENTIT dhe është subjekt reference për çdo pyetje në lidhje me Workoutet. Gjyqtarët janë të trajnuar dhe të aftësuar në lidhje me menaxhimin e çdo situatë gjatë zhvillimit të garës. Çdo bateri do të ketë drejtuesin e saj, i cili mund të jetë HEAD JUDGE ose një person tjetër i caktuar prej tij, dhe ka autoritetin të ndërhyjë drejtpërdrejt në gjykimin e një gjyqtari duke anuluar ose vërtetuar një vendim të tij.

Atletët duhet të pranojnë të sillen në mënyrë të drejtë dhe duke zbatuar parimet universale të fair play: manipulimet dhe tentativat për të mashtruar, sjelljet shqetësuese ose penguese ndaj mbarëvajtjes së eventit, komentet e dhunshme dhe fyese, ose çdo sjellje tjetër që synon të ofendojë, lëndojë ose dëmtojë imazhin e eventit apo pjesmarrësve në këtë event do të ndëshkohen nga drejtuesi i garës deri me përjashtimin nga gara. Ata gjithashtu mund të dënohen me penalitete në klasifikim për të gjitha sjelljet



josportive dhe çdo qëndrim të mundshëm që synon të dëmtojë organizatorët e eventit, pjesëmarrësit, sponsorët, spektatorët dhe të tjerët të pranishëm ose për të parandaluar konkurrentët e tjerë të marrin pjesë në konkurs në mënyrë të drejtë dhe korrekte.

Gjithashtu organizatorët rezervojnë të drejtën për të ndjekur në rrugë ligjore çdo çështje të mundshme për çdo kompensim të mundshëm të dëmeve.

9. ANKESAT E ATLETËVE

Vetëm atletët kanë të drejtë të paraqesin një ankesë gjatë garave, brenda tre orëve nga përfundimi i baterisë së tyre ose nga publikimi i rezultatit të baterisë së tyre. Formalizimi i ankeses bëhet vetëm duke plotësuar formularin përkatës pranë tavolinës së gjyqtarëve dhe duke paguar tarifën e përcaktuar. Çdo formë tjetër ankimi nuk do merret parasysh.

Kushti i nevojshëm për shqyrtimin e Ankesës është **plotësimi i formularit përkatës dhe pagesa e një tarife prej 50 euro**. Nëse pretendimi i atletit qëndron, vlera prej 50 euro do ti kthehet atij, e nëse pretendimi nuk qëndron, kjo vlerë i nuk kthehet mbrapsht.

Kryegjyqtari rezervon të drejtën të refuzojë një kërkesë dhe të gjitha vendimet e tij janë përfundimtare, pa të drejtë për ankim të mëtejshëm.

Tirana Throwdown nuk do të pranojë asnjë kërkesë tre orë pas përfundimit të baterisë përkatëse.

Videot, fotot, regjistrimet me telefon ose çdo media tjetër **NUK** do të përbëjnë bazë për ndryshimin ose modifikimin e vendimit, apo rezultatit të gjyqtarit. Kryegjyqtari mund të përdorë vetëm pamjet të cilat do sigurohen nga organizatorët e eventit.

Të pranishmit (spektatorë, sportistë, trajnerë, etj.) nuk lejohen të përdorin dron gjatë eventit për asnjë arsye.

Më poshtë janë shembuj të ngjarjeve ose veprimeve që një atlet mund të apelojë (me numërimin, gabimet e të dhënave ose dështimet e pajisjeve) por nuk përfaqësojnë një listë shteruese:

- Mospërputhje e të dhënave të fletës së rezultatit me tabelën përfundimtare
- Gabim në numërimin e përsëritjeve të sakta (p.sh. numri i përgjithshëm i përsëritjeve)
- Mospërputhje ose gabim në ngarkim të rezultateve
- Dështimi i pajisjeve ose monitorit që nuk ishte përgjegjësi e atletit
- Gabim në drejtimin e radhës së ushtrimeve nga ana e gjyqtarit
- Veprimi i një atleti ose personi tjetër që pengoi përparimin e tij

Më poshtë janë shembuj të ngjarjeve ose veprimeve që një atlet nuk mund të apelojë, por nuk përfaqësojnë një listë shteruese:

- Uljet në squats
- Drejtimi i hipseve, gjunjëve dhe krahëve
- Stabilizimi i peshave në pozicionin overhead

Shënime:

Disa lëvizje tipike mund të kualifikohen për rishikim; për shembull, rope climb apo handstand Walk. Për



shkak të kohës së zgjatur të nevojshme për të përfunduar një përsëritje në krahasim me lëvizjet e tjera më të shpejta (p.sh., përsëritjet e squat apo push press), ankesat që përfshijnë një "no rep" të diskutueshme mund dhe duhet të merren parasysh në këto raste.

Praktikisht, atletët nuk mund të ngrenë një ankesë kundër një atleti tjetër konkurrent. Megjithatë, gabimet e mëdha të sjella në vëmendje të ekipit të gjyqtarëve mund të hetohen në interes të mbarëvajtjes së drejtë të eventit.

10. QASJA NË FUSHË:

Vetëm atleti, një trajner për çdo palestër, gjyqtarët, vullnetarët dhe organizatorët e garës kanë akses në fushën e garës duke ndjekur protokollin e sigurisë.

Tifozë mund të futen vetëm në ambientet e dedikuara për sponsorët dhe në tribunën qendrore, gjithmonë jashtë perimetrit të sigurisë.

Secili kameraman ose fotograf, i pajtuar nga atletët, do duhet të kryejë një pagesë ditore prej 35 eurosh në mënyrë që të ketë akses të plotë brenda fushës për të bërë foto ose video, por gjithmonë pa cënuar ecurinë e garës. Numri i përgjithshëm i tyre gjatë një eventit do vendoset nga organizatorët e garës, në funksion të mbarëvajtjes së garës.

Zona e nxemjes, sipas rregullave të hyrjes, mund të aksesohet nga atletët në përputhje me protokollin, në oraret dhe mënyrat e përcaktuara, sipas kalendarit të garës, 20 minuta përpara se të fillojë bateria ku atleti merr pjesë.

11. DRUG POLICY

Atletët e skualifikuar nga ndonjë garë tjetër për përdorim të drogës për rritjen e performancës së tyre nuk lejohen të marrin pjesë në Tirana Throwdown për sa kohë që zbatohet ndalimi i tyre.

Përveç kësaj, Tirana Throwdown ka të drejtë të bashkëpunojë me organizatat ndërkombëtare anti-doping nëse kërkohet. Gjithashtu nëse kërkohet, atletët që marrin pjesë në event do të duhet të bashkëpunojnë duke marrë pjesë në programet e testimit të drogës. Nëse një atlet shmang, refuzon ose dështon t'i nënshtrohet një testi droge, atëherë Tirana Throwdown ka të drejtë ta përjashtojë atë nga eventit.

12. ÇMIMET E FITUESVE

Tirana Throwdown do shpërndajë një numër të madh çmimesh që shkojnë deri në vlerën 15 000 Euro.

Çmimet përkatëse për secilën kategori do publikohen përpara fillimit të eventit.

Nëse në kategorinë ELITE nuk plotësohet numri i pjesëmarrësve i përcaktuar në pikën 3 të kësaj rregulloreje, çmimet e fituesve për këtë kategori do të ulen me 25%.

Në një rast të tillë, çmimet përfundimtare do të publikohen pas mbylljes së regjistrimeve.

13. POLITIKA E PRIVATËSISË:

Lidhur me përpunimin e të dhënave personale Tirana Throwdown thekson se të dhënat personale të atletëve do të përpunohen për qëllime të lidhura rreptësisht me eventin. Këto të dhëna do të jenë objekt



i përhapjes në çfarëdo forme të imazheve ose videove të veta të marra në faqen e internetit, youtube, facebook, instagram, tik tok, platformën X, etj., të printuar dhe/ose në çdo mjet tjetër.

Tirana Throwdown do përdorë emailt e atletëve të regjistruar për të dërguar vetëm buletinet me email. Emailt e sportistëve të regjistruar nuk do t'u jepen palëve të treta. Të gjitha emailt e atletëve mbahen në serverët e Tirana Throwdown për një kohë të pacaktuar.

14. TE FUNDIT

Tirana Throwdown nuk është përgjegjës nëse shteti shqiptar apo autoritetet lokale ose ndërkombëtare kërkojnë që ngjarja duhet të shtyhet ose duhet të anulohet si rezultat i një ngjarjeje të Forcës Madhore (duke përfshirë, por pa u kufizuar në, fatkeqësitë natyrore, epidemitë, etj.). Nëse shteti shqiptar ose autoritetet kompetente kërkojnë që ngjarja të mos zhvillohet për asnjë arsye, një datë e re do të caktohet nga Tirana Throwdown në të njëjtin vend ose në një vend tjetër. Pjesëmarrja e atletëve do të transferohen automatikisht në datën e re dhe si atletët ashtu edhe spektatorët nuk do të duhet të paguajnë asnjë tarifë shtesë.

Tirana Throwdown nuk është përgjegjës për çdo tarifë që mund t'u shkaktohet atletëve dhe/ose spektatorëve për kostot ndaj palëve të treta (përfshirë, por pa u kufizuar në, hotelet, biletat e linjës ajrore, lundrimet, etj.).